

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	A rrezikojnë shqiptarët dëbimin nga Gjermania? Deputeti i AfD-së, Tobias Teich, sqaron qëndrimin
ADRESA	https://albeu.com/lajme/bota/a-rrezikojne-shqiptaret-debimin-nga-gjermania-deputeti-i-af-d-se-tobias-teich-sqaron-qendrimin/1010135/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 21:53:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 21:48:33 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	62bc16c4c93cf61fbb5cbd1563e43111d308ace4cddec413c38e4c39dba287fd
TEKSTI	beb1fdcf475f52cc0f0426e5f2078a89e9d818325fbe0bdd28938d691a091769
PAMJA	d238712b0fcc4ae25e9f18b49539d4bd16686be72bd4f1d75cdd53c7068bb233

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9717eb07e8eae890bfc0df37c49ef96ac4deed091e6bea47bfbdd0f6728eeb26
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f1c1a38f9771f79e512f664e18e6e88db80fe93efd6d7ebfef0798630764110e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9717eb07e8eae890bfc0df37c49ef96ac4deed091e6bea47bfbdd0f6728eeb26>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

A rrezikojnë shqiptarët dëbimin nga Gjermania? Deputeti i AfD-së, Tobias Teich, sqaron qëndrimin



Deputeti i AfD-së, Tobias Teich, ishte i ftuar këtë të diel në emisionin "Review", të moderuar nga Greta Topjana, ku foli për politikën e partisë së tij pas fitores në Gjermani. Gjatë intervistës, ai u pyet për qëndrimin e AfD-së ndaj emigracionit dhe nëse shqiptarët mund të preken nga këto politika.

Teich deklaroi se numri më i madh i emigrantëve nuk vjen nga Shqipëria, por kryesisht nga Siria dhe vendet afrikane, të cilat i cilësoi si zonat më problematike për sa i përket flukseve migratore.

Ai tha se Gjermania ka shpenzuar 12 miliardë euro gjatë vitit 2024 për çështjet që lidhen me azilkërkuesit. Sipas tij, njerëzit që vijnë nga vende të tjera, integrohen, pranojnë kulturën dhe sistemin gjerman, janë të mirëpritur dhe nuk përbëjnë problem.

Deputeti i AfD-së theksoi se kjo çështje nuk lidhet vetëm me shqiptarët, duke kujtuar se gjatë viteve 90 Gjermania priti një numër të madh refugjatësh nga Kosova. Teich tha se ka lindur në vitin 84 dhe se i përket një brezi që pa ardhjen e shumë njerëzve të larguar nga konfliktet, të cilët kërkonin siguri.

Ai shtoi se gjatë asaj periudhe pati kontakte me shumë kosovarë dhe se prej të rinjve mësoi për historinë e Kosovës. Më vonë, sipas tij, njohu edhe Shqipërinë dhe mori më shumë informacion për vendin.

Teich u shpreh pozitivisht për komunitetin shqiptar në Gjermani, veçanërisht kur bëhet fjalë për të dhënat statistikore mbi kriminalitetin. Ai nënvizoi se nuk ka probleme me personat që kanë ardhur nga Shqipëria.

"Nuk kemi probleme me njerëzit që kanë ardhur nga Shqipëria. Numrin më të madh të emigrantëve e kanë Siria dhe vendet afrikane, jo Shqipëria", deklaroi ai.

Deputeti sqaroi se vlerësimi i tij pozitiv për Shqipërinë ishte personal dhe se nuk mund të fliste

të fundit /



VIDEO/ Sherri në Laçi-Vllaznia, tifozët godasin me shapka dhe arbitri...



Patos, një person gjendet pa shenja jete në oborrin e banesës



BMW tërheq 189,130 automjete për shkak të rrezikut të zjarrit në...



Këto janë automjetet me mundësinë më të madhe për të kaluar...



VIDEO/ Goli i Rey Manajt u anulua nga arbitri, sulmuesi...



Rama në Elbasan: Bashkitë që do të bashkohen do të...



A rrezikohen shqiptarët nga politikën e AfD-së në Gjermani? Depute...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

domosdoshmërisht në emër të gjithë partisë. "Mund të them gjëra pozitive dhe në këtë rast po flas për veten time. Për Shqipërinë kemi një opinion pozitiv", u shpreh Tobias Teich.

Shtuar më 13.09.2026 23:48

Tags: [AFD](#), [aktualitet](#), [Lajm kryesor](#), [Review](#), [Tobias Teich](#), [vendi](#), [video](#)



Patos, një person gjendet pa shenja jete në oborrin e banesës



Përplasje me armë në Anavyssos, Alket Rizai në kërkim para rikthimit të...



LVV dhe LDK dakord për një kandidat konsensual për presidentin, Kraki: Së...



Pas fjalimeve, protestuesit nisin marshimin në bulevardet e Tiranës



Pas dasmës lukzose, këngëtarja e njohur Kida nis muajin e mjalitit/ Çifti...



Arben Kola njofton orarin e ri të protestës: Nga nesër grumbullimi në sheshin...



Protesta para Kryeministrit në ditën e 106-të: "Jemi mijëra dhe ...



Protestuesit marshojnë drejt Kryeministrit në ditën e 106-të të protestës:...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.